

Programi Interreg IPA CBC Italy- Albania-Montenegro

**“REEHUB – Metodologjia e thjeshtuar
e auditit të energjisë” – Deliverable
WPT1**

Deliverable WP T1

Project ref. no.	195	Project Acronym	REEHUB
Project Partner	PP3 - ENEA		
Activity	WPT1	WP1 Responsible partner	ENEA
Start date	1-2019	End date	15-9-2020
JS Project Officer			

REEHUB – Metodologjia e thjeshtuar e auditit të energjisë

P. Aversa, L. Fallucchi, G. Iannantuono, V. A.M. Luprano, M. Misceo (ENEA)

Qershor 2020

Projekti REEHUB

INTERREG IPA CBCITALY-ALBANIA-MONTENEGRO2014_2020

Aksi prioritar III: Mbrojtja e mjedisit, administrimi i rrezikut dhe strategjia për uljen e nivelit të karbonit

Objektivi Specifik 3.2: Promovimi i praktikave dhe mjeteve inovative për të zvogëluar emetimet e karbonit dhe për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në sektorin publik.

Partneri drejtues i projektit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ky dokument përshkruan aktivitetet e kryera në kuadër të WPT1 te projektit REEHUB

Përgjegjës Shkencor ENEA: Vincenza A. M. Luprano

Menaxheri i Projektit ENEA: Monica Misceo

Diagnoza energjitike: Leonardo Fallucchi dhe Giovanni Iannantuono (ENEA – DUEE – SIST – SUD)

Diagnoza instrumentale: Patrizia Aversa (ENEA – SSTP- PROMAS - MATAS)

PËRMBAJTJA

- 1 HYRJE NË UDHËZIMET E REEHUB PËR DIAGNOZËN ENERGETIKE**
- 2 PROCEDURA E THJESHTUAR PËR DIAGNOZËN ENERGETIKE**
 - 2.1 Përmbledhja e veprimeve që duhet të kryhen për diagnozën energjetike**
- 3 DIAGNOZA INSTRUMENTALE**
 - 3.1 Matja për transmetimin termik në vend**
 - 3.2 Matja e mikroklimës së brendshme**
 - 3.3 Kualifikimet e operatorit**
 - 3.4 Redaktimi i raportit**
 - 3.5 Kërkesat për sigurinë e operatorit**
- 4 VLERËSIMI EKONOMIK I NDËRHYRJEVE**
 - 4.1 Vlera aktuale neto**
 - 4.2 Fluksi i arkës**
 - 4.3 Faktori vjetor**
 - 4.4 Investimi neto**
 - 4.5 Treguesit ekonomikë**
- 5 KONKLUSIONE**

SHTOJCA:

Shtojca 1: Diagnoza energjetike HUB Tirana

Shtojca 2: Diagnoza energjetike HUB Podgorica

Shtojca 3: Diagnoza energjetike HUB Agnone

Shtojca 4: Diagnoza energjetike HUB Brindisi

HYRJE

Sektori i ndërtimit është thelbësor për të arritur objektivat energjetikë dhe mjedisorë të BE-së dhe për këtë arsye inkurajohen të gjitha përpjekjet që synojnë dekarbonizimin e stokut të ndërtesave. Ndërtesa më të mira e më efikase nga pikëpamja energjetike, përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve duke i sjellë përfitime të mëtejshme ekonomisë dhe shoqërisë.

Për këtë motiv Bashkimi Europian ka përditësuar direktivën 2012/27/ të Bashkimit Europian me **direktivën 2018/844** me objektiv promovimin e përhapjes sa më të madhe të efikasitetit të energjisë dhe energjive të rinovueshme në ndërtesa, për të siguruar që strategjitë afatgjata të ristrukturimit të japin përparimin e nevojshëm për të shndërruar ndërtesat ekzistuese në ndërtesa me energji gati zero deri në vitin 2050.

Auditimi energjetik është hapi themelor për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike, për të zvogëluar konsumin e energjisë dhe për të sjellë përfitime të lidhura me mjedisin. Për më tepër, vëmendje e veçantë iu kushtua, në përditësimin e Direktivës, sistemeve të kontrollit dhe automatizimit të ndërtesës, në mënyrë që të jenë në gjendje të vlerësojnë më mirë masat e efikasitetit të energjisë, duke krahasuar kostot dhe përfitimet e tyre, dhe të sensibilizojnë pronarët për kursimet reale nga funksionet e reja të përmirësuara të ndërtesës. Projekti REEHUB ka vendosur si objektiv kryesor, krijimin e qendrave të kompetencave, në 4 rajonet në fjalë, mbi eficienten e energjisë dhe ndërtimin e qëndrueshëm në përgjithësi. Kështu, para së gjithash, secili partner ka identifikuar një vend në Tiranë, Podgoricë, Brindisi dhe Agnone për të krijuar një HUB. Më tej, ENEA, për të transferuar praktikën më të mira për auditin e energjisë, ka konsideruar metodologjikisht të rëndësishme, jo vetëm kryerjen e trajnimeve formuese për këtë temë, për stafin e caktuar nga secili partner i projektit, por mbi të gjitha për të lejuar stafin e trajnuar të eksperimentojë në këtë fushë nocionet e mësuara, duke kryer auditime energjetike në HUB-e, duke përdorur mjetet e blera nga projekti.

Metodologjia e auditit të energjisë – REEHUB është një procedurë e thjeshtuar për diagnozën energjetike dhe është aplikuar në 4 HUB-et Rajonale.

Këto udhëzime synojnë të bëhen një manual për administratën publike vendore që merret me veprime energjetike, teknike dhe ekzekutive. Në faqet e mëposhtme tregohen hapat themelore për të realizuar një diagnozë të saktë të energjisë, duke filluar nga mënyra se si të sigurohen të dhënat përkatëse, si të përdoren mjetet teknike dhe si të kryhet një fushatë matëse, si të monitorohet konsumi i energjisë elektrike, si të interpretohen rezultatet e marra dhe si të bëhet një vlerësim i ndërhyrjeve më të favorshme energjetike duke i krahasuar ato me kostot.

Këto Udhëzime do të jenë të disponueshme për të gjithë palët e interesuara, siç janë universitetet, ndërtuesit, inxhinierët, arkitektët, institucionet financiare dhe zhvilluesit e pasurive të patundshme, duke shpresuar se ato do të jenë forca lëvizëse për një shpërndarje më të madhe dhe më të efektshme të praktikave të rikualifikimit energjetik për ndërtesat, në mënyrë që të japin një kontribut për arritjen e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050.

1. HYRJE NË UDHËZUESIN E REEHUB PËR DIAGNOZËN ENERGETIKE

Proçedura e thjeshtuar për diagnozën energjetike, e ilustruar në Udhëzimet e REEHUB, lejon të përcaktoni me lehtësi vlerën e Energjisë Parësore dhe treguesve të tjerë të energjisë, pa përdorimin e softwarëve llogaritës dhe/ose algoritmeve të artikuluar dhe komplekse.

Është një procedurë e menjëhershme “kantieri” dhe për këtë arsye gjithmonë i zbatueshëm, veçanërisht në ato raste, kur përdorimi i programeve dhe hetimeve shumë të hollësishme dhe të detajuara do të bëhej i shtrenjtë, si për sa i përket kohës, por dhe kostos; për shembull, kur doni të punoni vetëm në disa dhoma, brenda një apartamenti, kur keni nevojë për masa të efijçences së energjisë.

Këto Udhëzime për Auditin Energjetik bazohen në metodën e përdorur në EN 16247.

UNI CEI EN 16247-1 përcakton kërkesat, metodologjinë e zakonshme dhe produktet e diagnozave energjetike. Ajo vlen për të gjitha format e kompanive dhe organizatave, për të gjitha format e energjisë dhe përdorimin e saj, me përjashtimin e njësisive individuale të pasurive të patundshme rezidenciale. Ajo përcakton kërkesat e përgjithshme të zakonshme për të gjitha diagnozat energjetike.

Normativa UNI CEI EN 16247-2 është e zbatueshme për diagnozat energjetike specifike për ndërtesat. Ajo përcakton kërkesat, metodologjinë dhe raportimin e një diagnoze energjetike në lidhje me një ndërtesë ose grup ndërtesash, duke përjashtuar rezidencat individuale private.

Normativa UNI CEI EN 16247-3 përcakton kërkesat, metodologjinë dhe raportimin e një diagnoze energjetike brenda një procesi, në lidhje me: a) organizimin dhe kryerjen e një diagnoze energjetike; b) të analizojë të dhënat e marra me diagnozën e energjisë; c) raportojnë dhe dokumentojnë rezultatet e diagnozës së energjisë. Rregulli vlen për vendet ku përdorimi i energjisë është për shkak të procesit.

Më në fund, normativa UNI CEI EN 16247-4 përcakton kërkesat specifike, metodologjinë dhe raportimin për diagnozat energjetike në sektorin e transportit dhe adreson çdo situatë në të cilën bëhet një lëvizje, pavarësisht se kush është operatori (kompani publike ose private apo nëse operatori është i dedikuar ekskluzivisht për transport ose jo). Proçedurat e përshkruara këtu vlejné për mënyrat e ndryshme të transportit (rrugor, hekurudhor, det, ajër), si dhe për zona të ndryshme (lokale, në distancë të gjatë) dhe objektin e transportuar (kryesisht mallra dhe njerëz).

Proçedura e thjeshtuar, në thelb, kërkon përcaktimin e të dhënave, të cilat janë lehtësisht të arritshme me llogaritjet manuale dhe/ose të arritshme nga tabelat, grafikët e siguruar dhe/ose të përshkruara nga literatura dhe standardet teknike të sektorit.

Rezultatet përfundimtare që jep proçedura e thjeshtuar garantojnë një renditje sipas madhësisë, në vlerë absolute, jo shumë më të lartë se ajo që mund të përcaktohet me

përdorimin e softuerit të llogaritjeve, që ekziston në treg; gjithçka varet nga cilësia, përsa i përket saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave hyrëse, d.m.th. sa më të sakta janë të dhënat hyrëse në lidhje me realitetin aq më i vogël do të jetë ndryshimi midis rezultatit të marrë nga procedura e thjeshtuar me atë të marrë nga llogaritja me softuer.

Dallimi midis procedurës së thjeshtuar dhe asaj të parashikuar nga normativat (të përcaktuara në softuerin e sektorit) konsiston në arritjen e rezultateve të kërkuara, në një mënyrë të thjeshtë, të menjëhershme dhe me shpenzime ekonomike minimale për përdoruesit, pa humbur vëmendjen e konceptit fizik të sistemit ndërtesë - impiant dhe të gjithë parametrave që përdoren për llogaritjen e energjisë parësore; një procedurë shumë e dobishme, pra, për të gjithë ata që merren me këto koncepte pa pasur një përvojë të konsiderueshme pune në sektorin e inxhinierisë së impianteve termo-teknike.

Në këtë mënyrë, aplikimi i procedurës së thjeshtuar huazohet në mënyrë të përshtatshme në analizën e rasteve që nuk janë shumë komplekse, siç janë ato të drejtuara në disa ambiente/dhoma të një objekti që i nënshtrohen masave të efijencës së energjisë, apo për të gjitha ato raste në të cilat nuk ka nevojë të ndërhyhet në të gjithë ndërtesën.

Rezultati i marrë me anë të aplikimit të procedurës së thjeshtuar është i ndryshëm nga ai i marrë duke aplikuar algoritmet e përdorura nga softueri i llogaritjes (përsa i përket vlerës absolute) ose mund të jetë në një shkallë më të përafërt, por kjo është e mundur në varësi se sa të sakta janë të dhënat hyrëse në procedurë, të cilat janë në gjendje të arrijnë rezultatet e synuara, përsa i përket kursimit të energjisë dhe kohës së amortizimit të investimeve për ndërhyrjet në efijencën e energjisë, me devijime sa më të ulëta në raport me indeksin e kongrunitetit i përdorur për vlefshmërinë e modelit fiziko-matematikor të cilit i referohemi si në llogaritjet me softuer ashtu edhe në rastin në të cilin përdoret procedura e thjeshtuar (asnjëherë më shumë se 15%).

Si përfundim, përdoruesi që e gjykon të përshtatshme për të zgjedhur procedurën e thjeshtuar për të analizuar sistemin "ndërtesë-impiant", për arsye që justifikojnë përdorimin e tij, ose në çdo rast, sepse ai është vetë përdorues, duhet të kujdeset që të përcaktojë parametrat hyrës me precizion ekstrem sa më afër realitetit, në përputhje me kërkesat e literaturës dhe normativave teknike në fuqi, me qëllim që të arrijë rezultate që ndryshojnë pak nga ato më precizet të marra me softuerin llogaritës, por, në të njëjtën kohë, me avantazhin e një llogaritje të menjëhershme, më pak shpenzime ekonomike për përdoruesit të cilëve ju drejtohet dhe madje edhe më shumë me avantazhin kryesor të ndjekjes hap pas hapi dhe konkretisht, nga pikëpamja fizike, parametrat individualë të përdorur si të dhëna hyrëse si: (fuqitë termike, transmetimet, orët e punës, gradët e ditës, rendimentin, ndryshimet e temperaturës, koefijentët e ekspozimit, koefijentët për shkak të ndërprerjes së funksionimit të sistemit, etj).

Më në fund është e dobishme të mbani mend se diagnoza e energjisë, e përcaktuar si me përdorimin e softuerit apo me përdorimin e procedurës së thjeshtuar, ka si qëllim të sigurojë një rezultat paraprak të situatës, që ju lejon të vlerësoni ekzistencën ose jo të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e nismave të efijencës së energjisë në ndërtesë dhe impiantet e saj.

2. PROCEDURA E THJESHTUAR PËR DIAGNOZËN ENERGETIKE

Për të identifikuar masat më të favorshme ekonomisht të efijencës së energjisë, në lidhje me sistemin ndërtesë - impiant, ne përdorim DIAGNOZËN ENERGETIKE.

Më poshtë përshkruhen pikat thelbësore që përbëjnë veprimtarinë e diagnozës energjetike, të tilla që, përbëjnë një procedurë të thjeshtuar të zbatueshme edhe në ato raste, kur jo e gjithë ndërtesa duhet t'i nënshtrohet masave të efijencës, por vetëm disa ambiente në të.

1. Përftimi i të dhënave që na interesojnë për performancën energjetike (dimër, verë, etj) në lidhje me sistemin ndërtesë – impiant: karakteristikat teknike të mbështjelljes së ndërtesës, llojin dhe funksionimin e impianteve të pranishëm, konsumin e lëndëve djegëse, etj;
2. Analiza e sjelljes së performancës së energjisë të sistemit ndërtesë – impiant përmes algoritmeve të thjeshtuara dhe/ose më përgjithësisht përmes softuerit specifik; apo ndërtimit të modelit fiziko-matematikor që stimulon për diagnozë sistemin ndërtesë – impiant;
3. Llogaritja e indikatorëve specifikë që lejojnë krahasimin midis konsumit të llogaritur dhe atij të pritur (marrë nga analiza e përmendur në pikën e mëparshme) dhe atyre që rrjedhin nga faturat e energjisë (rezultatet/vlerat reale);
4. Krahasimi midis asaj që llogaritet dhe asaj që është në realitet (faturat e energjisë);
5. Nëse krahasimi është larg pritshmërive (përputhshmëri e ulët) është e nevojshme të modifikohen parametrat e përdorur si input, ose do të jetë e nevojshme të modifikohen të dhënat e përmendura në pikën 1 (karakteristikat e zonës, funksionimi i impianteve, etj), në mënyrë që treguesit e rinj, të përcaktuar pas ndryshimeve të jenë sa më të afërta me ato reale (pra përputhshmëri e mesme / e lartë);
6. Identifikimi i ndërhyrjeve të përmirësuara (izolimi i mureve, tarracës, zëvendësimi i dritareve, zëvendësimi i kaldajës, etj) dhe identifikimi i kombinimeve të ndërhyrjeve të ndryshme (zëvendësimi i dritareve + zëvendësimi i kaldajës). Kombinimi i ndërhyrjeve individuale duhet të rrjedhë nga ajo që tregohet kryesisht nga dëshirat e klientit, si dhe nga përparësia që rrjedh nga analiza ekonomike;
7. Analiza e sistemit ndërtesë – impiant me aplikimin, në modelin fiziko-matematikor, të ndërhyrjeve ose kombinimeve të ndërhyrjeve të efijencës së energjisë të identifikuara në pikën 6;
8. Analiza ekonomike që synon të përcaktojë përparësinë e kombinimeve të ndërhyrjeve ose përparësinë e ndërhyrjeve të veçanta të identifikuara - Lehtësia e ndërhyrjes ose kombinimeve të ndërhyrjeve; në përgjithësi, konsiderohen si të përshtatshme nga pikëpamja energjike dhe ekonomike duke pasur parasysh ndërhyrjet që amortizohen gjatë një periudhe jo më të gjatë se 15 vjet.

Në thelb, diagnoza e energjisë nuk bën gjë tjetër veçse të riprodhojë, gjatë analizës së sistemit ndërtesë – impiant, kushtet reale ndaj të cilave është vendosur sistemi.

Gjatë analizës, konsiderohet prurja reale impiantistike, e realizuar nga klienti dhe kushtet reale klimatike të diktuar nga temperaturat në ditët reale.

Këto të fundit janë marrë nga vlerësime të paktën tre-vjeçare mbi trendin e temperaturave ditore të orareve të parashikuara, për zonën në fjalë, nga organet publike që nxjerrin temperaturat përgjatë orëve të ajrit jashtë, duke iu referuar periudhës që dimri fillon në tetor dhe mbaron në prill.

Në këtë mënyrë, duke marrë parasysh prurjen reale dhe efektive të impiantit dhe trendin real të temperaturave të ajrit të jashtëm, në një periudhë të përcaktuar mirë, është i rëndësishëm krahasimi midis rezultateve të përcaktuara, me modelin fiziko-matematik të ndërtuar (pikat 1. dhe 2. të listës së mëparshme) dhe konsumit aktual të lëndëve djegëse dhe/ose energjisë elektrike.

Diagnoza energjetike nuk pretendon të përcaktojë vlerësime të sakta të përfitimeve ekonomike, por thjesht ju lejon të vlerësoni ekzistencën ose jo të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e efikasitetit të energjisë.

Sa më të sakta janë të dhënat e vëna në dispozicion nga klienti, aq më i lartë është niveli i thellimit të diagnozës energjetike dhe për këtë arsye, aq më të sakta janë rezultatet në lidhje me pritshmëritë ekonomike dhe energjetike të ndërhyrjeve.

Për të patur një Diagnozë Energjetike të saktë duhet të jenë të disponueshme:

- a. Të dhënat gjeometrike që kanë të bëjnë me dhomën e njësisë rezidenciale ose për ndërtesën e marrë në studim (planet, fasadat, prerjet, rilevimet, fotografitë e zonave të ekspozuara si: kufijtë, tarracat, ndërtesat përreth, llojin dhe madhësinë e dritareve, identifikimin e saktë të ekspozimit nga veriu, funksionin e ambienteve etj);
- b. Përdorimi i një termofluksimetri në vend, për matjet e transmetimit të elementëve të zarfit të ndërtesës (shiko par. 3);
- c. Lloji i impianteve të pranishëm, me të dhëna të sakta të orëve të ndezjes dhe të fikjes, si gjatë gjithë ditës dhe gjatë ditëve të javës (ku ditët me oraret e fikjes të zgjatura duhet të merren parasysh);
- d. Rilevimi dhe tipologjia e sistemit impiantistik në tërësi: sistemi i prodhimit, shpërndarjes, shkarkimit dhe rregullimit; Në veçanti, duhet të theksohen karakteristikat teknike të gjeneratorëve të nxehtësisë, pompave të nxehtësisë, komponentëve emëtues (radiatorë, panele diellore, multisplit, etj.);
- e. Nëse ekziston, është e dobishme të merrni të gjithë dokumentacionin e projektimit të impianteve ekzistuese;

- f. Të dhënat klimatike të zonës dhe vendit ku është realizuar zarfi i ndërtesës në studim, për të cilin duhen nxjerrë të dhënat reale, të paktën për tre vitet e fundit, të temperaturave (brenda 24 orëve) të ajrit të jashtëm. Të dhëna të disponueshme nga stacionet meteorologjike në zonë. Kjo do t'ju lejojë të përcaktoni të dhëna të rëndësishme dhe thelbësore, për llogaritjen e fuqive termike të kërkuara nga ndërtesa si dhe energjinë termike të kërkuar për të gjithë periudhën aktuale dhe efektive të ngrohjes. Në veçanti, do të jetë e nevojshme të përcaktohet temperatura minimale e jashtme e projektit (llogaritja e fuqisë termike të pikut) dhe temperature gjatë ditës (llogaritja e energjisë termike që kërkohet nga sistemi ndërtesë-impianjt);
- g. Konsumi dhe kostot e transportuesve të energjisë (lëndë djegëse / energji elektrike) që i referohen të paktën tre viteve të fundit të funksionimit dhe nëse është e mundur të referohen për çdo muaj;

Për të provuar një analizë të saktë, por të thjeshtuar të Hubit të energjisë të marr në studim, është e nevojshme të sigurohen të dhënat e mëposhtme dhe të bëhet një inspektim për të mbledhur të gjithë informacionin e dobishëm:

Emri i pronarit

Data dhe vendi i aktivitetit

Të dhëna të operatorit

Të dhënat e pasurisë së patundshme:

- Tipologjia e ndërtesës
- Viti i ndërtimit
- Komuna/qyteti/shteti;
- Lartësia në kate.
- Gjerësia;
- Shpejtësia e erës;
- Vendosje dhe përshkrimi i ndërtesës /njësi imobiliare/hub/lokal/ambient;
- Kategoria/destinacioni i përdorimit
- Vëllimi bruto i ngrohur
- Sipërfaqja totale humbëse
- Zona klimatike
- Gradë Ditë
- Zgjatje reale (muajore) e periudhës së ngrohjes (ditë)
- Zgjatje reale ditore e ndezjes/fikjes së impiantit (orë)
- Temperatura minimale ditore e llogaritjes (dimërore)
- Temperatura mesatare muajore
- Temperatura e projektuar e ajrit (në brendësi të ambientit/zona termike)
- Teknika e përdorur e ndërtimit:
- Përbërja e mureve perimetrale

Përshkrimi viziv i ndërtesës (Vizitë në terren):

- Relievi fotografik

- Tipologjia konstruktive mbajtëse
- Përbërja e mureve, shtresat e tij

Për më tepër, vlerat e mëposhtme të transmetimit për elementët e errët dhe të dritareve duhet të llogariten, në bazë të analizës të përshtatshme termoflукsometrike:

- Transmetimi i paretëve të jashtme;
- Transmetimi i dritareve;
- Transmetimi i ambienteve në kufi/zona të pa ngrohura;
- Transmetimi i ambientit kufitar me trupin e shkallës;
- Transmetimi i soletës mbi garazh/kantinë/portikatë/ambiente jo të ngrohur;
- Transmetimi i soletës /tarracës/çatisë;
- Transmetimi i dyshemesë;
- Transmetimi i mureve në tokë;

Të dhëna të impiantit:

- Orët e funksionimit të impiantit;
- Lënda djegëse e përdorur;
- Tipologjia e gjeneratorit të nxehtësisë/pompës së nxehtësisë dhe përcaktimi i vlerës së rendimentit të prodhimit;
- Tipologjia e sistemit të shpërndarjes së fluidit dhe përcaktimi i vlerës së rendimentit të shpërndarjes;
- Tipologjia e sistemit të emetimit dhe përcaktimi i rendimentit të emetimit;
- Tipologjia e sistemit të rregullimit dhe përcaktimi i rendimentit të rregullimit;

Ndërkohë, nevojitet të kryejmë:

1. Llogaritjen e fuqisë termike të humbur nga transmetimi (elementët opak dhe dritaret); Q_d ;
2. Llogaritjen e fuqisë termike të humbur nga ventilimi (natyror/mekanik); Q_v ;
3. Llogaritjen e diferencës së temperaturës (midis ajrit të brendshëm dhe të jashtëm minimal të projektit); DT ;
4. Llogaritjen e orëve reale të funksionimit të impiantit: hg (orë);
5. Llogaritjen e temperaturës ditore reale; GGr ;
6. Llogaritjen e sipërfaqes së shkelshme të habitit / njësiwe imobiliare/ndërtesës; Su ;
7. Llogaritjen e rendimentit të prodhimit; np ;
8. Llogaritjen e rendimentit të shpërndarjes ; nd ;
9. Llogaritjen e rendimentit të emetimit; ne ;
10. Llogaritjen e rendimentit të rregullimit; nr ;

11. Llogaritjen e rendimentit global mesatar stinor; $ng=np \times nd \times ne \times nr$;

Prandaj është e mundur, përmes të gjitha vlerave të llogaritura më parë, të përcaktohet vlera e Energjisë Primare të kërkuar:

$$E_{pr} = (Q_d + Q_v) \times GGr \times hg / (Su \times DT^\circ \times ng); \text{ (kWh/m}^2 \text{ * vjet)}$$

Në lidhje me vlerat që do t'i atribuohen rendimenteve të prodhimit, shpërndarjes, emetimit dhe rregullimit, mund të përdorim dhe/ose vlerat e referencës së diktuar nga normativat aktuale teknike (UNI TS 11300, rekomandimet e CTI, etj).

Ndërsa për llogaritjen e GGR (gradë ditore reale) do të jetë e nevojshme të përdoret formula e njejtë e dhënë nga normativa (llogaritja e gradëve të ditës) por duke përdorur, si vlerën e temperaturës mesatare ditore të ajrit, vlerat reale (të marra nga të dhënat e motit të njëjësive të kontrollit në zonë) duke iu referuar një periudhe të caktuar (periudha e ngrohjes).

Në këtë drejtim, për të llogaritur periudhën reale të referencës dhe temperaturën mesatare ditore të ajrit të jashtëm, procedoni si më poshtë:

- a. Analizojmë të dhënat e motit të temperaturave të ajrit (të dhëna në 24 orë) për çdo ditë të vetme duke filluar nga muaji tetor dhe deri në muajin prill (të paktën tre vjet në përputhje me vitet e faturimit të energjisë elektrike referuar të energjisë); zakonisht zgjidhen 3 vitet e fundit;
- b. Për çdo ditë, do të llogaritet temperatura mesatare ditore duke vepruar si më poshtë:
Do të zbulohen vlerat e mëposhtme: T min, T Max, T në orën 6:00, T në orën 20:00;
Me këto vlera do të llogaritet mesatarja aritmetike;
Vlera mesatare aritmetike do të konsiderohet si vlera e temperaturës mesatare ditore e ajrit në natyrë;

Në brendësi të periudhës së konsideruar fillimisht, Tetor-Prill, do të kërkojmë, duke filluar nga muaji Tetor, ditën në të cilën temperatura është e barabartë me 12 Celcius dhe që mbetet më e ulët se kjo vlerë për tre ditë radhazi.

Pasi të përcaktohet kjo ditë, ajo do të përfaqësojë fillimin e periudhës së vërtetë të ngrohjes.

E njëjta gjë do të bëhet për të përcaktuar ditën në të cilën përfundon periudha e ngrohjes; domethënë, brenda periudhës do të konsiderojmë fillimisht, ditën në të cilën temperatura mesatare ditore e ajrit të jashtëm do të jetë më e lartë se 12 gradë Celcius dhe do të mbetet mbi këtë vlerë për tre ditë rresht;
Pasi të përcaktohet kjo ditë, ajo do të përfaqësojë fundin e periudhës reale të ngrohjes.

Me të dhënat e llogaritura në këtë mënyrë, është e mundur të përcaktohet për secilin vit vlera e gradës-ditë reale, duke u siguruar që të njëjtat vite në studim janë të njëjtat vite referuar faturave të energjisë (gaz natyror, GPL, naftë, energji elektrike, etj.); zakonisht analizohen të paktën në çdo tre vjet.

Nga tre vlerat e GGr të llogaritura në këtë mënyrë, do të identifikohet më e rëndësishmja dhe rrjedhimisht do të identifikohet fatura relative e energjisë.

Pas llogaritjes së energjisë primare Epr, është e thjeshtë të përcaktohet vlera e konsumit të karburantit që hyn në sistemin e prodhimit (gaz natyror, gpl, energji elektrike), e cila do të krahasohet me faturat relative të energjisë.

Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të vërtetohet modeli i strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore i miratuar nga ne për analizën e performancës.

Validimi do të ndjekë këtë mënyrë:

- Llogaritja e konsumit të karburantit në pritje/hyrje (Ccomb) e përcaktuar në funksion të vlerës së llogaritur të Epr (vlerë e llogaritur me modelin e strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore të miratuar nga ne);

- Llogaritja e konsumit të karburantit real (C. Comb.) Referuar periudhës së ngrohjes për të përcaktuar gradët-ditë reale;

- Krahasimi i dy të dhënave të llogaritura më parë:

Ccomb. - C'comb = DCcomb (vlerë absolute); diferenca midis dy vlerave të konsumit (të hyrjes dhe reale) për t'u vlerësuar si një vlerë absolute;

Nëse $DCcomb. / Ccomb. < 5\%$; ekziston një përputhshmëri e lartë midis modelit të miratuar dhe atij real.

Nëse $DCcomb. / Ccomb. < 10\%$; ekziston një përputhshmëri e mesme midis modelit të miratuar dhe atij real.

Nëse $DCcomb. / Ccomb. < 15\%$; ka një pajtueshmëri të ulët midis modelit të miratuar dhe atij real.

Nëse $DCcomb. / Ccomb. > 15\%$; modeli i miratuar nuk është në përputhje me atë real.

Prandaj, në hipotezën e përputhshmërisë së ulët të modelit dhe në mënyrë të barabartë të moskonformitetit, duhet të korrigjohen të dhënat hyrëse në modelin e strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore të miratuar për të stimuluar analizën e performancës të sistemit ndërtesë-impianit, d.m.th. të dhënat do të duhet të rishikohen dhe rimodelohen sipas të dhënave relative të trasmitancës, rendimentit, emisionit, shpërndarjes dhe rregullimit të impiantit në shërbim, orët e funksionimit / fiksjes së impiantit, ose gjithçka që përbën të dhënat e hyrjes sipas modelit të miratuar për Analizë.

Do të llogaritet përsëri vlera e Epr-së, me të dhënat e reja të ri-moduluara, në mënyrë që të mund të bëhet përsëri krahasimi me konsumin real të karburantit.

Në momentin që kemi rezultatet e reja të Epr, të përcaktuara pas rishikimit të të dhënave hyrëse, krahasuar me C'comb (konsumin real) ata do të përcaktojnë së paku një përputhshmëri mesatare (<10%), është e mundur që të adoptohen të dhënat e fundit si model i strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore dhe më pas të vazhdohet me analizat e mëvonshme ekonomike për të vlerësuar ndërhyrjet dhe / ose kombinimin e përmirësimit të efikasitetit dhe rikualifikimit të energjisë.

Si përmbledhje, themi se modeli i miratuar stimulon në një mënyrë kongregative sistemin e ndërtesës/impianit real; ne kështu kemi vërtetuar modelin për të përvetësuar analizën e mëvonshme (model i vlefshëm).

Pas vlefshmërisë, do të jetë e mundur të llogaritet koeficienti $\mu = C' \text{comb.} / C \text{comb.}$.

Koeficienti μ do të aplikohet në analizat e mëvonshme në lidhje me ndërhyrjet dhe / ose kombinimet e ndërhyrjeve të efikasitetit të energjisë në mënyrë që të mund të llogaritet, për çdo simulim llogaritjeje, konsumi relativ i karburantit real (metani, gpl, naftë, energji elektrike, etj.);

Pas vlefshmërisë së modelit të strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore, i cili, pra, riprodhon me aderim të mirë për këtë arsye sistemi ndërtesë/impianit që i nënshtrohet diagnozës, është e mundur të identifikohet se cilat do të jenë ndërhyrjet individuale të efikasitetit të energjisë ose kombinimi i ndërhyrjeve të shumëfishta që duhet të kryhen në realitet; kjo do të jetë e mundur pasi të ndërtohet një shkallë përparësie e përcaktuar sipas analizës ekonomike.

Në thelb, përparësi do t'i jepet ndërhyrjeve dhe / ose kombinimit të ndërhyrjeve që do të amortizohen gjatë një periudhe kohe të shkurtër, e cila do të rezultojë në periudha kthimi më pak se 10-15 vjet (analiza e kosto - përfitim).

Pasi kemi vlerësuar modelin e strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore që riprodhon sistemi ndërtesë/impianit real, objekti që i nënshtrohet analizës/diagnozës energjetike, është e nevojshme të përdoret ky model për analizat e mëvonshme të fizibilitetit ekonomik (shiko faqen 4)

E përmbledhur, kjo do të thotë që ne do të përdorim këtë model për të qenë në gjendje të përcaktojmë, në kushte standarde, edhe vlerën e Epr në gjendjen para ndërhyrjes, ashtu edhe pasojat e mëvonshme në kushtet e pas ndërhyrjes.

Kushtet standarde do të thotë që në modelin e strukturuar sipas qasjes fiziko-matematikore të përshtatur dhe vlerësuar do të jenë të aplikueshme vlerat standarde të diktuar nga rregulloret teknike në fuqi përpara i përket GG (gradë ditë) dhe orët e punës të funksionimit të impianit

Ndërsa, gjendja pas ndërhyrjes (gjendja e ardhshme) nënkupton atë në të cilën hipotezohet realizimi i një ndërhyrje të vetme të efikasitetit të energjisë ose në përgjithësi kombinimet e disa ndërhyrjeve; po kështu, gjendja para ndërhyrjes nënkupton gjendjen reale dhe aktuale të sistemit ndërtesë/impianit që analizohet dhe studiohet (gjendja e punëve).

